

## **PROCESVERBAL 24/2024**

I mbajtur me rastin e takimit të 10 (dhjetë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 24.10.2024 duke filluar nga ora 9:00.

### **Rend dite**

**1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**

**3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-56304;**

**4.Të ndryshme;**

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

**Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Denis Sofra** - e hedh në votim pikën 1.

**Aprovohet pika 1**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;**

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime sa i përket vendimit dhe thotë që parashihen të jenë 5 anëtar të komisionit.

**Denis Sofra** - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

**Aprovohet Pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-56304;**

**Avni Bytyqi** - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që ky vendim është miratu mbledhjen e kaluar mirëpo fatkeqësisht pronën të cilën e kemi dhënë në shfrytëzim për 5 vite,nuk kishte qenë në listën e pronave të cilën e ka pas për obligim Drejtoria e Pronës ta publikoj vitin e kaluar dhe MAPL e ka kthyer në rishqyrtim si pasojë pse prona nuk është e publikuar në faqe të komunës dhe ne duhet ta shfuqizojmë.

**Denis Sofra** - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

**Aprovohet pika 3**

**Pika 4.Të ndryshme;**

**Nazim Shabanaj** - kam kërku disa herë rregullimin e lojërave të fëmijëve dhe ende asnjë masë nuk është marrë.Fëmijët në ato lodra rrezikohen të rrëzohen.

**Denis Sofra** - vendi ishte shumë i mirë por paisjet ishin të demoluara.Është mirë me iu drejtu DSHPE me një shpresë.Unë e kam pas një shqetësim në Gelancë sa i përket nxënësve të komuniteteve aty.

Vijueshmëria është jo e mirë te këta nxënës të komuniteteve dhe sipas një takimi me drejtoreshën aty,prindërit kanë shku në shkollë për ta marrë vërtetimin por drejtoresha nuk mund ti lëshoj vërtetimet

për nxënës të cilët kanë kalu shumë mungesa. Pastaj sipas drejtoreshë kishte ndodhur një lloj incidenti që prindërit ishin fjalos, i kishin kërcënu fëmijët aty dhe ka ndodh edhe rrahje dhe drejtoresha ishte e shqetësuar. A ka ndonjë mekanizëm DKA që së paku me shku dhe me bisedu me nxënësit, drejtoreshën por edhe me prindërit.

**Habibe Bytyqi** - realisht nuk është hera e parë sepse ne edhe vitin e kaluar kemi pas një iniciativë që është paraqit në këtë komunitet dhe kam kërkë prej këtij komiteti sepse shumë forma tjera janë provu me u ndërmarrë por prap ka rezultu jo e suksesshme sa duhet. Është një problematikë që përkundër shumë veprimeve që po i përdorim edhe si komunë dhe si organizata të huaja, edhe Komuniteti për Komunitete ka pas aktivite atje por kjo është gjendja. Sa i përket rrahjes unë nuk konsideroj që as DKA, as Komuniteti për Komunitete nuk mund të kryejnë punë këtu përpos policisë.

**Denis Sofra** - javën e kaluar pa e njoftu drejtoreshën dhe prindërit kam shku me zyrtarin e QKS-së në teren, fillimisht te familjet dhe të gjithë fëmijët kanë qenë në shkollë dhe kur shkova te drejtoresha edhe ajo më tha që fëmijët janë në shkollë.

**Habibe Bytyqi** - edhe Nazimi e ka pas një reagim të tillë ku ka thënë që fëmijët po shkojnë në shkollë.

**Nazim Shabanaj** - unë secilit prind i kam shku në shtëpi dhe ata kanë thënë që ne po i dërgojmë por ata ikin nga mësimi.

**Habibe Bytyqi** - edhe unë kam shku një herë për vizitë dhe ata kanë qenë në orë të muzikës.

**Nazim Shabanaj** - ka që bëjnë mungesa por nuk është në rregull me ja nal socialin.

**Avni Bytyqi** - aty ka punëtor teknik dhe është mirë me arrit një marrëveshje mirëkuptimi drejtoresha me prindërit që mos me i leju nxënësat me dal prej objektit të shkollës deri të përfundon mësimi.

**Aziz Bytyqi** - pajtohem me ato por po krijohet një problem shtesë sepse nëse nxënësi niset prej shtëpisë me shku në shkollë dhe ndërkohë nuk është në shkollë, ai është në rrugë. Rruga paraqet rrezikshmëri.

Veprimi i parë varet te mësimdhënësi në kuptimin e informimit të prindit nëse nxënësi ka mungu dhe këtu përfundon puna e mësimdhënësit sepse nuk mund ta mbaj me zor, e pastaj merret prindi. Drejtoresha është në hall dhe e kuptoj. Presioni i Komitetit është te pjesa financiare dhe mirë që u bë kjo sepse ata fëmijë të paktën shkojnë në shkollë.

**Denis Sofra** - shkolla në Tërrnje e ka ndalu me dal jashtë oborrit të shkollës dhe fëmijët ushqimin e marrin prej shtëpisë.

**Avni Bytyqi** - shkolla ka këshillin drejtues të shkollës, drejtorin, ka këshillin drejtues të prindërve dhe është mirë me arrit marrëveshje me mbyll shkollën.

**Takimi përfundoi: 09:25**